

K

faqësimit të Kosovës më ka mësuar se sa e rëndësishme është të mos barrikadohemi në koncepte të ngushta të intereseve partiake dhe synimin ta kemi interesin e shtetit. Në këtë gjendje që jemi, gjykoj se bashkëpunimi është i domosdoshëm, jo vetëm ndërmjet partive në fjalë, por edhe në një kontekst më të gjerë shoqëror e shtetëror.

**"Epoka e re":** Çfarë vlerësimi keni për situatën e përgjithshme në Kosovë?  
**Berisha:** Pa e zgjatur dhe komplikuar, ka shumë punë për të bërë. Unë jam bashkangjitur pikërisht për të punuar.

**"Epoka e re":** A mund të ndryshohet kjo me një qeverisje Haradinaj?  
**Berisha:** Ndryshimi nëpërmjet punës, angazhimit, disiplinës, profesionalizmit, ky është qëllimi i domosdoshëm.

**"Epoka e re":** Keni qenë ambasador në Slloveni. Cili është vlerësimi juaj për politikën e jashtme të Kosovës? Ka nevojë Kosova për një platformë të fuqishme për politikën e jashtme? Çfarë duhet përmirësuar MPI-ja?  
**Berisha:** Së pari, politika e jashtme është reflektim i politikës së brendshme dhe pa avancuar në këtë drejtim nuk mund të pretendojmë shumë. Së dyti, politika e jashtme është specifike dhe kërkon një trajtim të veçantë dhe të kujdesshëm. Mendoj se në strategjinë ka mundur të bëhet më shumë. Qasja e kufizuar në qendra me peshe evropiane dhe botërore, joproportionaliteti dhe mbifokusimi në disa vende e organizata në Afrikë e Azi më shumë ka sjellë debate të brendshme për (jo)meritoritetin sesa dobi reale për Kosovën. Politika e jashtme duhet të jetë parimore dhe çdo shmangie mund ta dëmtojë perspektivën tonë euroatlantike. Sa i përket shërbimit diplomatik, aty është punuar, por ende ka shumë punë për të bërë. Përfaqësuesit tonë diplomatikë, përveç imazhit për Kosovën, paraqesin edhe mesazhin që dërgojmë në shtet. Rasti i Romës, largimi i ambasadorit Prenkaj, për mua, një ndër diplomatët më të kompletuar që kemi, ishte mesazh jo i mirë dhe reduktues, gabim që nuk është dashur të ndodhë.

e Kosovës të kenë një perspektivë dhe jetë të dinjitetshme. Sigurisht se arrija e këtij qëllimi nënkupton synimin në integrimet euroatlantike dhe në arrijten shkallë-shkallë të standardeve të tyre.

**"Epoka e re":** Mendoni se vizioni juaj do ta gjejë hapësirën e duhur në AAK?  
**Berisha:** Sikur të mos mendoja e besoja, nuk do të kisha bërë një hap të tillë. Në fund të fundit, cila është alternativa e shtetit të Kosovës po të mos synojmë këto standarde dhe këtë orientim?

**"Epoka e re":** Besoni se AAK-ja do të dalë forcë e fuqishme politike pas zgjedhjeve të reja?  
**Berisha:** Sigurisht, dhe puna ime është të mos kursehem që kjo të ndodhë.

**"Epoka e re":** Besoni se AAK-ja do të dalë forcë e fuqishme politike pas zgjedhjeve të reja?  
**Berisha:** Sigurisht, dhe puna ime është të mos kursehem që kjo të ndodhë.

**"Epoka e re":** Besoni se AAK-ja do të dalë forcë e fuqishme politike pas zgjedhjeve të reja?  
**Berisha:** Sigurisht, dhe puna ime është të mos kursehem që kjo të ndodhë.

**"Epoka e re":** Tani kemi një afnim të mendimeve mes PDK-së dhe AAK-së për të bashkëqeverisur. Sa do të ishte në interes të shtetit kjo bashkëqeverisje. Apo jeni kundër një koalicioni të tillë?  
**Berisha:** Përvoja ime e për-

**Berisha:** Të më shpëtojë nga kush? Është për të ardhur keq që, siç thoni ju, një pjesë e "opinionit" u bashkua për të më bërë gjyqin e moralit, patriotizmit duke më "dënuar me vdekje". Kjo "pjesë" që nuk ka asnjë respekt për jetën, familjen dhe vlerat njerëzore, dhe ky botëkuptim që, siç do ta përkufizojë Papa Benedikti XVI, si "botë e vlerave të konsumit" tenton të imponohet me çdo kusht duke mos zgjedhur mjete e metoda. Unë vazhdimisht kam kërkuar që organet kompetente të bëjnë punën e tyre duke u mbështetur në standarde e fakte e jo në interpretime të lira e të qëllimshme. Tani, gjashtë vjet më pas, të them të drejtën, përsëritja e "akuzave" të tilla të trilluara e fiktive vetëm me forcon që përgjigjen ta jap me punë dhe kontribut të dobishëm.

**"Epoka e re":** Këto akuzat ndaj jush e dëmtojnë AAK-në?  
**Berisha:** AAK-ja është deklaruar se ndihet e nderuar me bashkëngjitjen time. Ky është obligim dhe detyrë për mua që nëpërmjet kontributit ta arsyetoj këtë respekt.

**"Epoka e re":** Ju thoni se akuzat ndaj jush janë të qëllimshme. Kujt po i pengon Anton Berisha?  
**Berisha:** Arsyetimet që në emër të interesit të publikut, individë dhe grupe të frustruara tentojnë të sajojnë teori duke u bazuar në insinuata dhe aludime në shkelje të rënda dhe përsëritja e tyre pa qarë kokën për faktet si dhe marrja në dorë e monopoli të vërtetës, patriotizmit, të transparencës dhe drejtësisë dhe liria që i kanë dhënë vetes ta përballojnë secilin që "ua prish planet e interesin", është vërtetuar se është rrugë e rrezikshme. Angazhimi im në politikë është synim që të ketë rregull e rend dhe përgjegjësi institucionale për çfarëdo veprimi dhe sigurisht edhe masa adekuate ligjore. Nëse Nënë Tereza ka jetuar/vepruar me moton "Dëshuria në veprim", ne në AAK synojmë të punojmë me moton "Shteti në veprim".

**"Epoka e re":** Çështje shumë të rëndësishme mbeten edhe atentatet ndaj jush. Cila është vërteta?  
**Berisha:** E vërteta është konsolidimi i shtetit të Kosovës me standarde të shteteve të Bashkimit Evropian, ku institucionet kompetente të jenë në funksion të çdo qytetari, të drejtës elementare për jetë, të mundësisë që çdo qytetar ta realizojë ëndrën e tij, të ketë një jetë të dinjitetshme që nënkupton liri, punësim dhe mundësi të barabartë. Pra, një rrugë e gjatë është para nesh dhe nuk kemi për të ndenjur, kemi shumë punë për të bërë!

**"Epoka e re":** Çështje shumë të rëndësishme mbeten edhe atentatet ndaj jush. Cila është vërteta?  
**Berisha:** E vërteta është konsolidimi i shtetit të Kosovës me standarde të shteteve të Bashkimit Evropian, ku institucionet kompetente të jenë në funksion të çdo qytetari, të drejtës elementare për jetë, të mundësisë që çdo qytetar ta realizojë ëndrën e tij, të ketë një jetë të dinjitetshme që nënkupton liri, punësim dhe mundësi të barabartë. Pra, një rrugë e gjatë është para nesh dhe nuk kemi për të ndenjur, kemi shumë punë për të bërë!

## Kosova kërkon që FSK-ja të jetë ushtri

Këshilli i NATO-s në qershor të këtij viti pritet të vendosë për të ardhmen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë shprehur optimizëm se 2013 do të jetë i transformimit të FSK-së në ushtri, ndërsa përfaqësuesit e NATO-s dhe të KFOR-it ka thënë se FSK-ja pritet të marrë përgjegjësi të reja, duke u bazuar në trajnimet që ka kryer

PRISHTINË, 13 JANAR - Autoritetet e Kosovës këtë vit kanë në plan ta transformojnë Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) në një ushtri moderne dhe të armatosur lehtë. Zëdhënësi i KFOR-it, Aleksandër Villing, ka vlerësuar se FSK-ja ka bërë përparim të madh, por aftësia e saj e plotë funksionuese do të përcaktohet nga NATO. "Vendet e NATO-s po shqyrtojnë kohën e duhur për miratimin përfundimtar të FSK-së. Këshilli i Atlantikut të Veriut, organizimi më i lartë vendimarrës i NATO-s do të marrë një vendim politik mbështetur në vlerësimin e autoriteteve ushtarake të NATO-s", ka thënë Villing për "SETimes".

Ndërkaq zëdhënësi e NATO-s, Oana Lungescu, ka deklaruar se Forca e Sigurisë së Kosovës është e dizajnuar dhe e përgatitur të arrijë të marrë një numër detyrash të sigurisë. "Pritet që FSK-ja të marrë përgjegjësi për funksionet që është trajnuar, kurse këto përgjegjësi kanë të bëjnë me zgjidhjen e situatave të jashtëzakonshme, heqjen e mjeteve shpërthyes dhe mbrojtjen civile", është shprehur Lungescu, duke shtuar se FSK-ja mund të jetë e dobishme për secilin qytetar që jeton në Kosovë. "Këto forca tashmë janë përdorur në situata të ndryshme për t'i evituar pasojat nga përmbytjet, pasojat e reshjeve të botës dhe heqja e minave dhe mjeteve të tjera eksplozive, që tregojnë se FSK-ja mund të jetë e dobishme për secilin në Kosovë", ka thënë Lungescu për agjencinë serbe të

lajmeve, "Beta". Këshilli i NATO-s në qershor të këtij viti pritet të vendosë për të ardhmen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Zëdhënësi e ministrit të FSK-së, Remzije Zeqiraj, ka deklaruar për "SETimes" se rekomandimet e KFOR-it dhe NATO-s janë të qarta. FSK-ja ka arritur aftësitë e plotë funksionale. Tani presim një konfirmim mbi rekomandimin e KFOR-it për FSK", është shprehur Zeqiraj. Studiuuesi në Qendrën për Politikën e Sigurisë në Beograd, Marko Saviq, ka vlerësuar se transformimi i FSK në një forcë të armatosur me përmasa të plota do të kërkojë kohë. "Procesi mund të nisë, por me siguri nuk do të përfundojë në 2013-n", ka thënë Saviq, duke shtuar se Serbia do të vazhdojë të punojë me NATO-n. Në anën tjetër, Florian Qehaja, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Studime të Sigurisë në Prishtinë, ka thënë se zhvillimet e reja në Kosovë, veçanërisht pas një pakësimi të vazhdueshëm në praninë e KFOR-it u kërkojnë autoriteteve ta shqyrtojnë mandatin e FSK-së. "Kosova ka nevojë për një ushtri të vogël, pak më të madhe se FSK ... të aftë për detyrat e mbrojtjes civile, pjesëmarrjen në misionet paqeruajtëse dhe sigurimin e integritetit të Kosovës", është shprehur Qehaja. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Agim Çeku, në fund të vitit që e lamë pas pati deklaruar se 2013 do të jetë viti i ushtrisë së Kosovës.

